



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 205 dt.20.10.1994

PER
RRITJEN E PAGAVE TE KESHILLAVE DREJTUES TE
NDERMARRJEVE LOKALE TE INDUSTRISE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.20.10.1994, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e pagave të Këshillave Drejtues të ndërmarrjeve lokale të industrisë”, në zbatim të V.K.Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993, mbështetur në kopetencat që i jep këtij Këshilli ligji Nr.7582, dt.13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, neni.19, pika.5 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10.

VENDOSI

1. Aprovimin e pagave të mëposhtëme :

1.Për degën artistike dhe të artizanatit

1.Ndërmarrja Artistike “Migjeni” (Druri).

- Paga e drejtorit të jetë 6.000 lekë në muaj.

2.Ndërmarrja Prodhime Artizanatit Nr.1

- Paga e drejtorit të jetë 6.000lekë në muaj.
- 2. Për anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjes, kur kanë detyrën K.Degës teknike apo ekonomike, paga e tyre të jetë 15 përqind më e vogël se ajo e drejtorit, ndërsa për specialistë anëtarë të Këshillit drejtues paga e tyre të jetë 20 përqind më e vogël se ajo e drejtorit.
- 3. Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.623, dt.31.12.1993, drejtorit i ndërmarrjes dhe anëtarët e Këshillit Drejtues përfitojnë rritje mbi pagë (kur plotësojnë kushtet) mbi 5 deri 50 përqind, në të njëjtën masë që do të përfitojnë punonjësit e tjerë të ndërmarrjes.
- 4. Këto paga sipas ligjit do të zbatohen nga 1 Janari 1994.

KRYETARI

BESNIK PETRELA